



Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d), lidhur me nenin 14 dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.03.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë

Neni 1

1.1 Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e Xhamisë, për lagjen e “Shirokë” në pjesën e parcelës kadastrale P-72116043-00804-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej; 10951m², sipas certifikatës së pronës nr.1165/2023, datës 13.03.2023, zona kadastrale Sopijë, vendi i quajtura “Drum/Shiroko” e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.

1.2 Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës të cekur në piken 1.1, të nenit 1, të këtij vendim, ndahen 1200m² për ndërtimin e “Xhamisë”, për lagjen në “Shirokë”, ndërsa pronari i përhershëm i pronës mbetet Komuna e Suharekës.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim dhe Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër e Komunës së Suharekës, të cilat do të bëjnë parcelizimin dhe skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastrale.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS- SUHAREKË

01-Nr- 016-21225
Më datë 30.03.23



Kryesuesi i Kuvendit
Mr.ec Bexhet KUÇI